

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Ortakëve të Shoqërisë

“Besa Agro Invest” Sh.p.k

NIPT L41726002A

Adresa: Durrës Fushe Kruje Arrameras, zona kadastrale nr. 1042,
godina nr.334/2 pranë Qendrës së Teknologjive Bujqësore Fushe Kruje.

Opinionit

Ne kemi audituar Pasqyrat financiare bashkëlidhur të shoqërisë “Besa Agro Invest” Sh.p.k, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve të veta dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si dhe shënimet lidhur me këto pasqyra financiare dhe një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur, në të gjitha aspektet materiale, japin një pamje të vërtetë dhe të sigurtë për pozicionin financiar të shoqërisë “Besa Agro Invest” Sh.p.k më 31 Dhjetor 2020, të performancës financiare dhe flukseve të parasë për ushtrimin që mbyllet në këtë datë, pasqyra të cilat janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Pasiguritë Materiale Lidhur me Vijimësinë

Ne tërheqim vëmendjen në Shënimin 12 të pasqyrave financiare, i cili tregon që Shoqëria pësoi një humbje neto prej 34,390,236 lekë gjatë vitit që mbyllet në 31 Dhjetor 2020, megjithatë, detyrimet korrente nuk kanë tejkaluar aktivet saj totale në 31 Dhjetor 2020. Siç është deklaruar në shënimin 12, kjo ngjarje tregon që ekziston një pasiguri materiale e cila mund të hedhë dyshime për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Opinioni jonë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Informacione të tjera

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera dhe duke bërë këtë, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër është dukshëm jo konsistent me pasqyrat financiare ose bazuar në njohuritë tona të marra gjatë auditimit, të vlerësojmë nëse ato dukshëm janë paraqitur me anomali materiale. Në qoftë se bazuar ne punën që ne kemi kryer, ne arrijmë në konkluzion se gjenden anomali materiale në këto informacione, ne do të raportojmë këtë fakt.

Sa më sipër ne nuk kemi gjë për të raportuar.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të të përmirësuar, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe që të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Kompanisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Kompania të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.
- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit. Ne gjithashtu ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Tirane me, 28 Maj 2021

Enkeleda Stefani

Auditues Ligjor

Adresa:Rr.Vaso Pasha ,Nd22, H23 AP4
Tirane Albania
Mobile:+355682005013
e-mail:enkeleda.s@fin-es.com

Enkeleda Stefani

ENKELEDA STEFANI
EKSPERT KONTABEL